

# Analiza vjetore e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit per vitin 2019

## I. Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Palët

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2019, DCLMP ka realizuar objektivat e mëposhtëm:

### 1. Legjislacioni

- U miratuan ndryshimet në Ligjin 9870/2008 “Për Standardizimin”, të ndryshuar dhe u dërgua brenda afatit në Këshillin e Ministrave për miratim.

### 2. Suport teknik e financiar nga Bashkimi Evropian për standardizimin në shqipëri

Në Nëntor 2019 ka filluar nga zbatimi Projekti “Mbështetje për DPS për t’u bërë anëtare me të drejta të plota në CEN&CENELEC”. Projekti do të zgjasë deri në 4 Nëntor 2020 dhe fondi është 300.000 Euro.

### 3. Bordi Drejtues

Janë mbajtur 2 mbledhje të Bordit Drejtues të DPS, në zbatim të VKM 433/2010 “Për krijimin, përbërjen, mënyrën e funksionimit dhe kompetencat e Bordit Drejtues të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit”. Në zbatim të këtij vendimi bordi ka funksionuar dhe miratuar Planin Vjetor 2019 të DPS, ecurinë dhe ka ndjekur zbatimin e objektivave të DPS për 2019.

### 4. Komunikimi/Marrëdhëniet me publikun

- Të gjitha eventet e standardizimit janë publikuar *online* në [www.dps.gov.al](http://www.dps.gov.al) përfshirë këtu edhe takimet dhe dokumentat e miratuara nga Bordi Drejtues, rregulloret, buletinet, Katalogu i Standardeve Shqiptare, njoftime në Sekretariatit e ISO / IEC dhe CEFTA, artikuj të ndryshëm promovues, takimet me kompani private, prodhues të materialeve të ndërtimit dhe palë të interesuara, standardi më i ri i publikuar nga DPS.
- Janë publikuar rreth **20** artikuj promovues dhe rreth **88** ekstrakte të fushave për standarde me interes për biznesin dhe ekonominë, si dhe mbi 20 njoftime/organizime/aktivitete të ndryshme nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizimin (ISO), Komiteti Evropian për Standardizimin (CEN) dhe nga Komiteti Evropian i Elektroteknikës për Standardizimin (CENELEC).
- Janë publikuar rreth **400** postime të ministrisë në rrjetet sociale të DPS.
- Numri i klikimeve është rritur ndjeshëm këtë vit krahasuar me vitet e kaluara - Në total janë marrë më shumë se **28,600 klikime** për publikimet në mediat sociale: [DPS facebook](#) [DPS Google](#) + dhe [DPS LinkedIn](#).

- Është publikuar dhe shpërndarë Katalogu i Standardeve Shqiptare 2019 në versionin elektronik me CD dhe janë shpërndarë mbi 250 Katalogë.
- Janë publikuar dhe shpërndarë Buletinët Informativë të DPS (78, 79, 80) dhe janë kontaktuar kompani biznesi të ndryshme, ku i është dhënë informacion mbi standardet, zbatimin e tyre, çertifikimin dhe mbi skarcot/humbjet gjatë procesit të prodhimit;
- Janë kryer notifikimet dhe janë dhënë të gjitha përgjigjet për pyetjet/kërkesat e ardhura brenda dhe jashtë vendit, lidhur me standardet dhe rregullat teknike me ndikim në tregti.
- Janë shqyrtuar dhe përgatitur komentet për të gjitha projektaktet ligjore e nënligjore me ndikim në tregti.

## 5. Përmirësimi i shërbimit ndaj qytetarëve

- Databaza e Standardeve Shqiptare siguron porosisë *online* për shitjen e Standardeve, gjë që rrit ndjeshëm përmirësimin e shërbimit ndaj biznesit dhe çdo pale tjetër të interesuar për standarde, duke shkurtuar kohën dhe kostot e tyre për blerjen e standardeve.
- Gjithashtu, Databaza e mësipërme siguron edhe leximin falas, në zyrat e DPS-së, nga çdokush që është i interesuar për të lexuar tekstin e standardit apo standardeve sipas fushës së interesit.

## 6. Shitja e Standardeve Shqiptare

Për këtë vit:

- Janë shitur gjithsej **688** standarde ose **23% më shumë** nga planifikimi, nga të cilat:
  - Standarde Evropiane EN 492;
  - Standarde Ndërkombëtare ISO 138;
  - Standarde puro Shqipëtare SSH 55;
  - Standarde Ndërkombëtare IEC 3.

## 7. Adoptimi i standardeve

Janë adoptuar gjithsej **2,321** standarde Evropiane dhe Ndërkombëtare, duke bërë që realizimi i programit të punës për DeS të jetë **102%**

Janë realizuar **114** Vendime adoptimi ku janë angazhuar rreth **62** Komitete Teknike.

Gjatë vitit 2019 ka pasur **15** kërkesa të reja për pjesëmarrje në Komitetet Teknike të DPS nga sektori publik dhe privat, në fushat si më poshtë:

- Cilësia e ujit, ajrit dhe tokës;
- Materiale ndërtimi;
- Mjedisi, siguria teknike dhe mjedisi;
- Sheshet me lodra dhe terrenet sportive;
- Qumështi, mishi dhe nënproduktet e tyre;
- Kimia;
- Materiale dhe pajisje elektrike.

## 8. Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Gjatë 2019 veprimtaria e institucionit ka rezultuar pa shkelje dhe në përputhje me ligjin 152/2013, të ndryshuar dhe akteve të tjera në zbatim të tij.

Struktura e DPS është e plotësuar dhe funksionon sipas Urdhërit të Kryeministrit nr.182, datë 26.12.2018 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit”. Janë të miratuar nga DAP për DPS 13 nëpunës civilë, 1 student të ekselencës dhe 1 punonjës me kontratë pune.

## 9. Transferimi i zyrave të DPS

Bazuar në Urdhërin e Ministrit të MFE nr.365, datë 14/10/2019 “Për kalimin në përdorim të ambjenteve të ëish-Drejtorisë Rajonale të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave tek Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit” në Tetor 2019 zyrat e DPS u transferuan në rrugën “Reshit Çollaku” Godina e ILDKPKI, Kati 6, Tiranë, për të cilën janë kryer punimet përkatëse. Transferimi u krye brenda pak ditësh, duke siguruar kështu shpejt funksionim normal të punës së DPS.

## 10. Buxheti i DPS

Buxheti i miratuar për 2019 në vlerën 33,500 mln leke u rrit në 34,500 mln lekë për shkak të transferimit të ambienteve të DPS tek ambjentet e reja.

Zërat e buxhetit **paga, sigurime, shpenzime operative dhe kuotat ndërkombetare** janë respektuar dhe pagesat janë bërë në kohën e duhur.

### - DPS Realizimi buxhetit (000 leke)

Nr.	Zerat e buxhetit	Plan	Fakt	% realizimit
1	Paga	15,000	14,680	98%
2	Sigurime	2,500	2,342	94%
3	Shpenzime operative	15,050	13,239	88%
4	Investime	2,000	1,286	64%
	<b>Totali</b>	<b>34,550</b>	<b>34,546</b>	<b>91%</b>


Shpenzimet operative kane % me te ulet te realizimit

Fondi shtese i kerkuar nuk u realizua per shkak te punimeve te pa mbaruara dhe difekteve te shfaqura dhe situates se jashtezakonshme në kohë e tërmetit.

1. Prokurimet janë bërë duke respektuar procedurat dhe afatet e ligjit te PP dhe sipas nevojave të DPS.
2. Eshtë respektuar hartimi dhe zbatimi i PBA dhe investimeve.
3. Të ardhurat kanë arritur në vlerën 1,333 mln lekë për vitin 2019 dhe derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit

#### - Të ardhurat

Planifikimi bëhet në numër standardesh të shitura dhe jo në vlere. Numri eshte realizuar dhe tejkaluar. Vlera nga viti i kaluar eshte 1,585,000 leke dhe në 2019 eshte realizuar shitja ne vleren 1,391,351 leke.



## 11. Problematikat

- Mbetet e vështirë çështja e adoptimit me përkthim të plotë të të gjithë tekstit të standardeve, duke qenë se procesi i përkthimit është shumë teknik dhe kërkon njohje jo vetëm të gjuhës, por edhe të fushës përkatëse dhe se ekspertët e Komiteteve Teknike nuk mund ta realizojnë këtë detyrë mbi baza vullnetare.
- Gjithashtu, paraqet problematikë Databaza e Standardeve ose Sistemi i Menaxhimit të Standardeve si për disa nga proceset e shqyrtimit dhe hedhjes së të dhënave të standardeve ashtu edhe në shitjen e standardeve, përgatitjen online të faturave, etj.